



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 35-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 26.03.2025, në sallën numër 2, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Valon Pacolli, DEZH
2. Shkelzen Hajdini, DSHPS
3. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të e KPF-së.
2. Propozim Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Lipjan.
3. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

4. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares të Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

5. Raporti Janar - Dhjetor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.

Pastaj Kryesuesi Daut Azemi, tha se kemi një propozim për tërheqjen e një pike nga rendi i ditës, po i'a kaloj fjalën drejtorit.

Shkelzen Hajdini DSHPS, tha se kam një propozim për tërheqjen e pikës së 2-të të rendit të ditës Propozim Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Lipjan, pasi që në bazë të informatave nga QPS-ja, do të ndryshohet udhëzimi administrativ për QPS dhe do të bëhen të gjitha statutet njësoj duke u bazuar në atë udhëzim.

Arsim Jashari, tha se e kam lexuar statutin dhe e kam parë që ka kundërshtime në te. E mbështesim që me u shty.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me propozimin që të hiqet pika e dytë nga rendi i ditës.

Pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për, aprovoi rendin e ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për, Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 34-të të KPF-së

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim propozimin.

Pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për, aprovoi Propozimin.

II

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-LLugiqi drejtoreshë e DKRS , e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 6 vota për, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares të Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Valon Pacollit, drejtor i DBF-së, i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 7 vota për , aprovoi propozimin.

Kryesuesi tha se propozoj që pika e 4 , Raporti Janar - Dhjetor 2024 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale të kaloj direkt për kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 7 vota për , aprovoi propozimin.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:50

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Daut Azemi